



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.05.2023

**MBLEDHJA Nr. 25,**  
**Datë 05.05.2023, ora 12:00**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 05.05.2023, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 25 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalëve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 28.04.2023 dhe 02.05.2023.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “EU GREEN ENERGY” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik i erës “Dropulli Wind”, me kapacitet të instaluar 20 MW, në Njësinë Administrative Jorgucat, Bashkia Dropull, Qarku Gjirokastrë.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW, në zonën kadastrale 3358, Fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**